Rregullimi i fotos on-line

26 02 2008

Për përpunimin e fotografive nuk
është e domosdoshme të keni të instaluar Photoshop. Shërbimet online për këtë qëllim janë avancuar aq shumë sa që ofrojnë edhe përpunimin e fotografive – dhe atë në të shumtën e rasteve pa pagesë. Ja disa programe që mund t’ju lehtësojnë përpunimin e fotografive.

Snipshot

Snipshot është shumë i thjeshtë për përdorim, lexon shpejt fotografitë, ndërsa për përpunim online mjafton një lidhje e kënaqshme interneti. Përpunon fotografitë deri në 10 megabajt, e veçanërisht është i dobishëm opsioni undo, i cili ka numër të pakufizuar të hapave prapa. Megjithatë, Snipshot është program i cili mundëson vetëm përpunimin e fotografive. Më së shumti i mungon opsioni për shkurtim dhe ndryshim të madhësisë së fotografisë, që thuajse përdoren më të shumti.

Pixenate

Ky është një program jashtëzakonisht i lehtë për t’u përdorur. Gjatë përpunimit të fotografive pak më të mëdha duhet të pritet që programi të bëj punën e vet dhe në përgjithësi gjatë punës me të duhet të kihet pakëz durim. Ekziston edhe një nën-rubrikë e plotë e pajisjeve të cilat janë përcaktuar si zbavitëse, por në parim janë shumë të dobishme për përpunimin e fotografive. Një prej lëshimeve është mungesa e opsionit për theksim të fotografisë.

Splashup

Ky editor pos dukjes ka edhe opsione ambicioze për përpunimin e fotografive. Do të gjeni mbështetje për filtrat, shtresat, pajisje të shumta, e shumë praktik është bashkëpunimi me shërbimet e fotove Picasa e Flickr, si dhe me shërbimin çdo ditë e më të popullarizuar Facebook. As Splashup nuk është pa të meta, ndërsa një prej më të mëdhave që ka, është shpejtësia. Nëse përpunoni një fotografi pak më të madhe, përgatituni për pritje dhe jostabilitet, bukur

shpesh ndodhë që thjesht të ndalon të reagojë në klikime.